



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0100

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi – Kryetar, Isa Hasani dhe Vjosa Gradinaj Mexhuani Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) N.SH.T. VIKTORY COM, dhe Asfalt Group kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit të KOMUNA E GJAKOVËS në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Rrugës X” me numër të prokurimit 632-23-397-5-1-1, me 29/03/2024, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE N.SH.T. VIKTORY COM me nr. 2024/0100, e datës 06/02/2024, kurse vendimi i AK KOMUNA E GJAKOVËS lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Rrugës X” me numër të prokurimit 632-23-397-5-1-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.
2. Hedhet poshtë si e palejuar ankesa e Operatorit ekonomik (OE) Asfalt Group, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me datën 02.02.2024, numër protokolli 2024/0090, për aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i rrugës X” me nr. të prokurimit: 632-23-397-5-1-1, iniciuar nga MINISTRIA E MBROJTJES, pasi që OE ankues konsiderohet si palë pa interes juridik material, konform nenit 4 paragrafi 1.26 të LPP-së.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik N.SH.T. VIKTORY COM dhe Asfalt Group.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale --

Me 14.04.2023, KOMUNA E GJAKOVËS në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Rugës X” me numër të prokurimit 632-23-397-5-1-1. Ndërsa me datën 22.01.2024 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Me 26.01.2024, OE N.SH.T. VIKTORY COM ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 30.01.2024, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 26.01.2024, Operatorit ekonomik (OE) Asphalt Group ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin B58 të Autoritetit Kontraktues. Me 30.01.2024, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim me arsyetimin se sipas vendimit e OSHP Nr.2023/0560 të datës 08.12.2023 Grupi i Operatoreve ekonomik Asphalt Group sh.p.k, Gurëbardhi sh.p.k., Benita Company, Dreoni sh.p.k nuk janë të përgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit.

Me 06.02.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE N.SH.T. VIKTORY COM me nr. 2024/0100 lidhur me aktivitetin “Ndërtimi i Rugës X” me numër të prokurimit 632-23-397-5-1-1 dhe me datën 02.02.2024, Operatorit ekonomik (OE) Asphalt Group, ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 2024/0090 lidhur me aktivitetin e përshkruar si me sipër.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE N.SH.T. VIKTORY COM janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) – “Arsyeja e dhënë nga ana e AK në njoftimin e datës 18.01.2024 për anulimin e tenderit “Ndertimi i Rruges X” me nr. te prokurimit:632-23-397-5-1-1, nuk është arsye që do mund të përdoret për anulim te tenderi pas hapjes së ofertave. Madje në këtë rast Grupi i operatorëve ekonomik N.SH.T. “VIKTORY COM”, Company Eskavatori SH.P.K.,Marisa SH.P.K., me përfaqësues N.SH.T. “VIKTORY COM” (Pjeter Qerimi B.I.), ka qenë në pritje të nënshkrimit të kontratës me AK Komuna e Gjakovës dhe atë konform Vendimi i OSHP: OSHP: 2023/0560- OSHP: 2023/0572, i datës 08.12.2023, i cili vendim këtë grup të operatorëve ekonomik e ka gjetur të përgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit, dhe ka kërkuar nga ana e Autoritetit Kontraktues procedim tutje drejt lidhjes se kontratës. 1.4. Arsyeja e dhënë nga AK në njoftimin e datës 18.01.2024 për anulimin e tenderit ka të bëjë me rastet kur ofertat ende nuk janë hapur. Arsyeja të cilën e ka përdorur AK për anulimin e tenderit ka formulim identik dhe parashihet me nenin 43, paragrafi 8, pika 1, të Rregullore nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, ku shprehimisht parashihet “Procedura e prokurimit para hapjes së ofertave mund të anulohet për arsyet e mëposhtme: për shkak të ngjarjeve të demonstrueshme dhe / apo arsyeve që janë jashtë kontrollit të AK dhe se nuk ishin të parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve;”. Ashtu siç është cekur edhe me lartë në këtë shkresë, ne rastin konkret nuk kemi të bëjmë me një situatë para hapjes se ofertave, mirëpo gjendjen e kemi pas hapjes se ofertave dhe pas konfirmimit nga OSHP se grupi i operatorëve ekonomik N.SH.T. “VIKTORY COM”, Company Eskavatori SH.P.K.,Marisa SH.P.K., me përfaqësues N.SH.T. “VIKTORY COM” (Pjeter Qerimi B.I.) është i përgjegjshëm për tenderin “Ndertimi i Rruges X” me nr. te prokurimit:632-23-397-5-1-1, dhe duhet proceduar me nënshkrim të kontratës. Rrjedhimisht, Njoftimi i datës 18.01.2024 është në kundërshtim me nenin 43, paragrafi 5, të Rregullore nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Me një veprim të tillë Komuna e Gjakovës e ka shkelur edhe nenin 62, paragrafi 2.2 të Ligjit për Prokurimin Publik i plotësuar dhe ndryshuar, në të cilin parashihet se “para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.”1.5. Veprimi i marrë nga ana e Komunës se Gjakovës për anulim të tenderit qartazi është veprim i kundërligjshëm dhe i cili është bërë me qëllim të dëmtimit të grupit ekonomik N.SH.T. “VIKTORY COM”, Company Eskavatori SH.P.K.,Marisa SH.P.K., me përfaqësues N.SH.T. “VIKTORY COM” (Pjeter Qerimi B.I.). Arsyetimi që është dhënë në njoftimin e datës 18.01.2024 paraqet shkelje direkte e nenit 62, paragrafi 2.2 të Ligjit për Prokurim Publik, dhe nenit 43 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, për shkak se as Ligjit për Prokurimin Publik, dhe as Rregullorja nr. 001/2022 për Prokurimin Publik nuk e lejojnë që anulimi i tenderit të bëhet pas hapjes së ofertave dhe pak para nënshkrimit të kontratës me operatorin ekonomik.”

Pretendimi i dytë (II) -Në pjesën Sqarim të Njoftimit e datës 18.01.2024 për Anulimin e Tenderit nga AK thuhet se “Me datë 13.12.2023, me kërkesë të zyrtarëve dhe kompanisë projektuese nga Ministria e Infrastrukturës kemi mbajtur takim në zyrën e Kryetarit, ku nga Ministria për Infrastrukturë është prezantuar projekti ideor për zgjerimin e rrugës Rajonale R107 (Istog-Prizren). Kjo rrugë sipas planeve tona në fuqi parasheh që të përfshijë edhe segmentin e

Rrugës X (Skivjan Lugbunar), që do të jetë rrugë e kategorisë rajonale. Andaj, për shkak të kategorizimit të kësaj rruge si rrugë Rajonale e që sipas Nenit 3, paragrafi 5.1 të LIGJIT Nr. 03/L-120 PER NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PER RRUGE NR. 2003/11, kjo rrugë i takon Ministrisë, po ashtu duke u bazuar në projektin që Ministria po zhvillon kjo rrugë do të financohet dhe ndërtohet nga Ministria e Infrastrukturës. Kërkojmë nga ju që të anuloni këtë aktivitet në mënyrë që të ri-planifikojmë mjetet për infrastrukturë lokale e që janë nën kompetencën e Komunës.” Ky Sqarim i ofruar nga ana e AK Komuna e Gjakovës nuk përkon me legjisllacionin në fuqi, si dhe është në kundërshtim me gjendjen faktike.1.7. Duke e parë arsyetimin e dhënë në Njoftimin e datë 18.01.2024, më datë 25.01.2024 i jemi drejtuar me email z. Hysen Durmishi Zëvendësministër i të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ku nga i njëjti kemi kërkuar që ta na njoftoj nëse Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka marrë ndonjë veprim i cili mund të dërgoj deri të vendimi i Komunës së Gjakovës për anulim të tenderit “Ndertimi i Rrugës X” me nr. të prokurimit:632-23-397-5-1-1. Këtij emaili i është përgjigjur Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ku në përgjigjen e tyre theksojnë se “Nga ana e komisionit për hartimin e projektit rrugës” Hartimi i projektit kryesorë – zbatues për Zgjerimi i Rrugës Rajonale, Istog-Pejë-Gjakovë-Prizren, nuk është kërkuar asnjëherë asgjë që ka të bëjë me punët e brendshme dhe procedurat e brendshme të Komunës së Gjakovës. Takimi ynë ka pasur vetëm karakter të pastër teknikë. Për më në detaje JU lutëm shikoni korrespondencat e bashkëngjitura në attachment”. Ky email më së miri e vërteton se ajo çka ka paraqitur Komuna e Gjakovës në njoftimin e datës 18.01.2024 është jo e vërtetë dhe se nuk ka pasur asnjë përfshirje të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në projektin në fjalë. Provë: Emaili i dërguar z. Hysen Durmishi më datë 25.01.2024; Provë: Përgjigja e kthyer nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës lidhur me emailin që e ka dërguar NSHT Viktory Com.”

Pretendimi i tretë (III) – “Shkelja tjetër e bërë nga ana e AK në njoftimin e datës 18.01.2024 ka të bëjë me bazën ligjore të cilës AK i referohet në hyrje të këtij njoftimi. AK në hyrje të njoftimit thekson se Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues, sipas nenit 43.7, dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik. Në nenin 43, paragrafi 7, të këtij akti parashihet që “Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave mund të anulohet për arsyen e mëposhtme: a. të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK.” Në rastin konkret oferta e Grupit të Operatorëve Ekonomik N.SH.T. “VIKTORY COM”, Company Eskavatori SH.P.K., Marisa SH.P.K., nuk e ka tejkaluar buxhetin, madje ka qenë më e ulët sesa limi i caktuar nga AK. Po ashtu, referenca në këtë bazë juridike është në kundërshtim me Vendimin e OSHP për këtë rast, për shkak se në këtë rast sipas vendimit të OSHP Grupi i Operatorëve Ekonomik N.SH.T. “VIKTORY COM”, Company Eskavatori SH.P.K., Marisa SH.P.K., është i përgjegjshëm dhe më të lidhet kontrata.”

Pretendimi i katërt (IV) -Në fillim në këtë procedurë të prokurimit AK Komuna e Gjakovës më datë 24.07.2023 kishte shpërblyer me kontratë Grupin e Operatorëve Ekonomik PE-VLA-KU SH.P.K. DEGA NË KOSOVË; JOOS & KRASNIQI BAZË; Roza Komani B.I.; në vlerë totale të ofertës 4,270,543.21 Euro. Mirëpo, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka aprovuar ankesën e Grupit të Operatorëve Ekonomik N.SH.T. “VIKTORY COM”, Company Eskavatori SH.P.K., Marisa SH.P.K., të paraqitur ndaj njoftimit të datës 24.07.2023 të cekur si më lartë, dhe

e ka shpallur Grupin e Operatorëve Ekonomik N.SH.T. “VIKTORY COM”, Company Eskavatori SH.P.K., Marisa SH.P.K të përgjegjshëm, dhe ka kërkuar nga ana e Autoritetit Kontraktues procedim tutje drejt lidhjes së kontratës. Tani pasi që Grupi i Operatorëve ekonomik me përfaqësues N.SH.T. “VIKTORY COM” (Pjeter Qerimi B.I.) është shpallur i përgjegjshëm nga OSHP dhe ka mbetur vetëm nënshkrimi i kontratës, Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Gjakovës në procedurë të ri-vlerësimit nxorri vendim me të cilin e anuloi aktivitetin e prokurimit si më lartë, dhe atë duke u thirrur në komunikime me email që disa zyrtarë të Komunës së Gjakovës kanë pasur me një zyrtar të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Pra, siç mund të shihet AK Komuna e Gjakovës e ka vështirë që të nënshkruaj kontratë me Grupin e Operatorëve Ekonomik N.SH.T. “VIKTORY COM”, Company Eskavatori SH.P.K., Marisa SH.P.K. Mirëpo, edhe përkundër asaj që AK Komuna e Gjakovës për arsye të cilat mund t’i ketë e të cilat nuk janë ligjore nuk e dëshiron lidhjen e kontratës me Grupin e Operatorëve Ekonomik N.SH.T. “VIKTORY COM”, Company Eskavatori SH.P.K., Marisa SH.P.K, e njëjta nuk mund t’i ikë përgjegjësisë dhe duhet ta lidhë kontratën me Grupin e Operatorëve Ekonomik N.SH.T. “VIKTORY COM”, Company Eskavatori SH.P.K., Marisa SH.P.K, konform Ligjit për Prokurimin Publik, si dhe konform Vendimit të OSHP: OSHP: 2023/0560- OSHP: 2023/0572, i datës 08.12.2023. Po ashtu e theksojmë se Vendimet e OSHP janë ekuivalente me vendimet e gjykatave, andaj mos zbatimi i këtyre vendimeve paraqet vepër penale mos zbatim i vendimeve gjyqësore. Siç kemi cekur me lartë Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës si dhe njësia kërkuuese kanë tentuar që të bëjnë manipulim me disa imella të shkëmbyer me Ministrin e Infrastrukturës, si rrjedhojë e këtyre imellave është vërtetuar mashtrimi i tyre me përgjigjen e dhen nga kjo Ministri. Këto veprimi që janë marr nga zyrtarët e prokurimit dhe njësia kërkuuese AK Komuna e Gjakovës duhet të trajtohen si keq përdorim i detyrës zyrtare dhe nga kjo rrjedh se këta zyrtarë duhet të ndëshkohen nga Institucionet e Republikës së Kosovës dhe Organet kompetente.”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër OE N.SH.T. VIKTORY COM konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore duke propozuar që të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet vendimi i AK dhe të kthehet lënda në rishqyrtim.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 09.02.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2024/0100 ndërsa me datë 21.02.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0100 me rekomandimet si në vijim: *“Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.”*

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është deklaruar se nuk pajtohet rreth rekomandimit të raportit të ekspertit shqyrtues duke theksuar *“Autoritet Kontraktues nuk pajtohet me ekspertizën Nr.2024/0100 datë 21.02.2024 për shkak se anulimi i procedurës është bërë konform nenit 62 të LPP-së pika 1.1”*, ndërsa OE është deklaruar se

pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues duke theksuar se “*Pajtohemi me mendimin e ekspertit kërkojmë nga paneli të aprovohet si e bazuar ankesa jone dhe lënda të kthehet ne Rivlerësim.*”

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova ekspertizën, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OEN.SH.T. VIKTORY COM eksperti shqyrtues përmes raportit të ekspertizës nr. 2024/0100 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në gjithë dokumentacionin e bashkangjitur vlerëson se një procedure e prokurimit pas hapjes së ofertave, mund të anulohet për:

43.5 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme:

a. asnjë tender nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar;

b. asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;

c. numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE është më pak se 3(tre);

d. nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;

e. numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociata është më pak se 3;

f. nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;

g. asnjë nga projektet e pranura në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm;

h. nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit;

i. një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;

j. nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes së procedurës ka përdorur gabimisht opsionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i pariparueshëm; ose

k. nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP.

Andaj, asnjë nga arsyetjet e paraqitura sipas nenit 43.5 të Rregullave 001/2022 nuk e parasheh anulimin e një procedure së prokurimit sipas disa emailave (po ashtu në emailat e bashkangjitura në ankese) askund nuk është e specifikuar që duhet të anulohet kjo procedure (por që specifikohet vetëm disa darkordime të takimeve) dhe si të tilla këtu nuk kanë asnjë vendim të asnjë institucioni që paraqet që kjo procedure duhet të anulohet dhe se tendencat e AK për anulimin e procedurës pa baze ligjore edhe pse ka oferta të përgjegjshme paraqet mos respektim të: Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregullave e Udhëzuesve tjerë në fuqi. Në këtë rast, ankesa e OE duhet të karakterizohet si ankese e bazuar dhe arsyetimi i anulimit nuk është anulim i mbështetur në dokumente faktike, ligj dhe rregullore.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtrirat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues,

ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrësat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë.

Në këtë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës për ankesën e N.SH.T. VIKTORY COM është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura. Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që ankesa e OE ankues N.SH.T. VIKTORY COM aprovohet si e bazuar, të anulohet vendimi i AK dhe aktiviteti i prokurimit “Ndërtimi i Rrugës X” me numër të prokurimit 632-23-397-5-1-1 të kthehet në Rivlerësim pasi që anulimi i një aktiviteti të prokurimit pa bazë ligjore edhe pse ka oferta të përgjegjshme paraqet mos respektim të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Ndërsa, ankesa e OE Asphalt Group hedhet si e palejuar sepse për këtë aktivitet të prokurimit është palë pa interes juridik material, konform nenit 4 paragrafi 1.26 të LPP-së. për shkak se me vendimin 790/23, i njëjti është konsideruar si i papërgjegjshëm, prandaj Ankuesi nuk mund të arrijë të dëshmojë se ka statusin e palës së interesuar sipas dispozitës 4, 1.26 të LPP-së.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues gjatë rivlerësimit të jenë të vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veprojnë në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi.

Paneli vlerëson se ankesa e OE ankues përsëritet për herë të dytë dhe se ankesa konform Rregullores së Punës së OSHP-së konkretisht neni 16.2 të trajtohet si “Res Judicata”. Po ashtu neni 105 paragrafi 2.16 i LPP-së e obligon Kryetarin e Panelit Shqyrtues ta trajton ankesën si çështje të gjykuara “res judicata”. Në bazë të sqarimeve të lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozojnë panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet vendimi i autoritetit kontraktues dhe rekomandon që lënda të kthehet në Rivlerësim. Pas analizimit të shkresave të lartpërmendura të cilat i kishte në dispozicion Paneli Shqyrtues, si: Ankesa e OE ankues, raportet e ekspertit shqyrtues, vendimin nr.2023/0572, dihet mirë se vendimet e OSHP-së janë të detyrueshme për autoritetet kontraktuese dhe të gjitha palët në procedurë, dhe se kundër vendimeve të OSHP-së, palët mund të ankohen në gjykatën kompetente brenda afatit ligjor me mjete të rregullta juridike, në përputhje me këshillën juridike të dhënë në vendim. Andaj, Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues (AK) Komuna e Gjakovës që në tërësi të zbatohet vendimet e OSHP.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Lidhur me tarifën ankimore është vendosur konform nenit 31 pika 4 dhe 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - N.SH.T. VIKTORY COM**
- Arkivës së OSHP-së: